

Shoqata e kontabilistëve të certifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Raportimi Financiar

P5

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Shënim: Emrat e individëve, vendeve dhe kompanive, të përdorura në këtë provim janë fiktive. Çdo ngjashmëri është plotësisht e rastësishme

Data 21.06.2025

1. Me 1 prill 2024, Buffett sh.a bleu 18 milionë aksione të ekuitetit në Ackman sh.a. në një këmbim aksionesh në të cilën Buffett sh.a. emetoi dy aksione të reja për çdo tre aksione që bleu në Ackman sh.a. Për më tepër, më 31 mars 2025, Buffett sh.a. do t'u paguajë aksionarëve të Ackman sh.a. €2.64 për çdo aksion të blerë. Kostoja e kapitalit të Buffett sh.a. është 10% në vit. Në datën e blerjes, secili aksion në Buffett sh.a dhe Ackman sh.a kishte një vlerë të tregut prej €9.75 dhe €3.75 respektivisht.

Pasqyrat e fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

	Buffett sh.a	Ackman sh.a
	€'000	€'000
Të hyrat	193,800	114,000
Kosto e shitjeve	<u>(153,600)</u>	<u>(78,000)</u>
Fitimi bruto	40,200	36,000
Kosto e shpërndarjes	(4,800)	(5,400)
Shpenzimet administrative	(11,400)	(7,200)
Të ardhurat nga investimet	1,500	-
Kosto financiare	<u>(1,260)</u>	<u>-</u>
Fitimi para tatimit	<u>24,240</u>	23,400
Tatimi në fitim	<u>(8,400)</u>	<u>(4,800)</u>
Fitimi për vitin	15,840	18,600

Ekstrakt nga pasqyra e ndryshimeve në ekuitet për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

	Buffett sh.a	Ackman sh.a
	€'000	€'000
Ekuiteti me 1 janar 2024		
Kapitali aksionar [emetuar me €2.25 për aksion]	180,000	45,000
Fitimet e mbajtura 1 janar 2024	162,000	105,000

Informata shtesë:

- i) Në datën e blerjes, vlerat e drejta të pasurive të Ackman sh.a ishin të barabarta me vlerat e tyre kontabël me përjashtim të dy zërave:

- Një zë i fabrikës kishte një vlerë të drejtë prej €5.4 milionë mbi vlerën e tij kontabël. Jetëgjatësia e mbetur e fabrikës në datën e blerjes ishte tre vjet. Zhvlerësimi i ngarkohet koston së shitjeve.
- Ackman sh.a kishte një detyrim kontigjent të cilin Buffett sh.a e vlerësoi të kishte një vlerë të drejtë prej €1.35 milionë. Kjo nuk ka ndryshuar me 31 dhjetor 2024.

Ackman sh.a nuk i ka përfshirë këto ndryshime të vlerës së drejtë në pasqyrat e saj financiare.

- ii) Është politike e grupit Buffett sh.a të vlerësoj interesin jo-kontrollues sipas sipas vlerës së plotë (të drejtë) të pasurive neto të identifikueshme të degës (filialit) në datën e blerjes. Për këtë qëllim, çmimi i aksioneve të Ackman sh.a. në atë datë mund të konsiderohet përfaqësues i vlerës së drejtë të aksioneve të mbajtura nga interesi jo-kontrollues.

- iii) Shitjet nga Buffett sh.a tek Ackman sh.a gjatë gjithë vitit që përfundoi më 31 dhjetor 2024 kishin qenë njëtrajtësisht isht €2.4 milionë në muaj. Buffett sh.a aplikoi një marzhë mbi kosto prej 25% në këto shitje. Ackman sh.a kishte €4.5 milionë euro të këtyre mallrave në stoqe më 31 dhjetor 2024.
- iv) Të ardhurat nga investimet e Buffett sh.a janë dividendë të marrë nga investimi i saj në një shoqëri në pronësi prej 40% (Templeton sh.a) të cilin e ka mbajtur për disa vite. Fitimet e shoqërisë për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2024 ishin €6 milionë, nga të cilat u deklarua dhe u pagua një dividend total prej €3.75 milionë.
- v) Edhe pse Ackman sh.a ka qenë fitimprurëse që nga blerja e saj nga Buffett sh.a, tregu për produktet e Buffett sh.a është goditur rëndë në muajt e fundit dhe Buffett sh.a ka llogaritur se zëri i mirë është dëmtuar me €6 milionë më 31 dhjetor 2024.

Kërkohet:

- a) Llogaritni zërin e mirë në blerjen e Ackman sh.a. (5 pikë)
- b) Përgatitni pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes për grupin Buffett sh.a për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024. (15 pikë)

(Total: 20 pikë)

1.

a) Zëri i mirë në blerje	€'000
Konsiderata e transferuar	
Aksionet ($2/3 \times 18m \times €9.75$)	117,000
Konsiderata e shtyrë ($18m \times €2.64 \times 1/1.1$)	<u>43,200</u>
	160,200
Vlera e drejtë e IJK-së ($2m \times €3.75$)	<u>7,500</u>
	167,700
Vlera e drejtë e pasurive neto	
Kapitali aksionar	45,000
Fitimet e mbajtura ($105,000 + (18,600 \times 3/12)$)	109,650
Korrigjimet e vlerës së drejtë	5,400
Detyrimi kontigjent	<u>(1,350)</u>
	(158,700)
Zëri i mirë në blerje	9,000
Dëmtimi	<u>(6,000)</u>
	3,000

b) Grupi Buffett sh.a
Pasqyra e konsoliduar të fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024
€'000

Të hyrat ($193,800 + (114,000 \times 9/12) - 21,600$ (L12))	257,700
Kosto e shitjeve ($153,600 + (78,000 \times 9/12) - 21,600 + 900$ (L12) + $1,350$ (L13))	<u>(192,750)</u>
Fitimi bruto	64,950
Kosto e shpërndarjes ($4,800 + (5,400 \times 9/12)$)	(8,800)
Shpenzimet administrative ($11,400 + (7,200 \times 9/12)$)	(16,800)
Dëmtimi i zërit të mirë	(6,000)
Kosto financiare (L14)	(4,500)
Pjesa e fitimit të shoqërisë ($6,000 \times 40\%$)	2,400
Fitimi para tatimit	31,200
Tatimi në fitim ($8,400 + (4,800 \times 9/12)$)	<u>(12,000)</u>
Fitimi për vitin	19,200
I atribuar tek:	
Pronarët e prindit	18,540
Interesi jo-kontrollues (L15)	<u>660</u>
	19,200

Llogaritjet

1. Struktura e grupit

	Ackman sh.a
Buffett sh.a [18m/20m]	90%
IJK 2m/20m	10%
Data e blerjes 1 prill 2024 [Para = 3 muaj; Pas 9 muaj]	

2. Tregtia ndërgrupore	€'000	€'000
Tregtia ndërgrupore (2,400 × 9 muaj)		
Të hyrat	21,600	
Kosto e shitjeve		21,600
FPR (4,500 × 25/125) = 900		
Kosto e shitjes	900	
Stoqet e grupit (PPF)		900
3. Korigjimet e vlerës së drejtë		
	Në blerje	Levizja
	€'000	€'000
Fabrika	5,400	(1,350)*
*(5,400 / 3) × 9/12		
4. Kosto financiare		€'000
Buffet sh.a sipas PFH		1,260
Anulimi i skontimit për konsideratën e shtyrë: ((43,200 × 10%) × 9/12)		<u>3,240</u>
		4,500
5. Interesi jo-kontrollues		€'000
Fitimi për vitin (18,600 × 9/12)		13,950
Zhvlerësimi në korigjimin e dlerës së drejtë (L13)		(1,350)
Dëmtimi i zërit të mirë		<u>(6,000)</u>
		6,600
Pjesa e IJK-së 10%		660

2.

a)

Fisher sh.a investon në obligacione të cilat i mban deri ne maturim.

Fisher sh.a bleu një obligacion më 1 janar 2024, detajet e të cilit janë si më poshtë:

Vlera nominale	€47.25 milionë
Norma e kuponit	4%
Çmimi i blerjes	€40.425 milionë
Norma efektive	6.75%

Obligacioni u ble me qëllim mbajtjen e tij për një kohë të gjatë dhe arkëtimin e interesit dhe kryegjësë kur ato të maturojnë.

Kuponi, i cili duhet të paguhet më 31 dhjetor të çdo viti, është paguar sipas kontratës.

Kërkohet:

Për obligacion më sipër, tregoni trajtimin e raportimit financiar të kërkuar nga SNRF 9 *Instrumentet Financiare* për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024. Tregoni qartë të gjitha llogaritjet. (8 pikë)

b) Krawcheck sh.a ndërton ndërtesa për klientët, të cilat mund të zgjasin shumë vite për t'u përfunduar. Krawcheck sh.a ka 3 kontrata në progres më 31 dhjetor 2024, të cilat janë detajuar më poshtë. Të gjitha kontratat më poshtë filluan në vitin aktual.

	Kontrata 1	Kontrata 2	Kontrata 3
	€'000	€'000	€'000
Çmimi	20,000	16,000	8,000
Kosto e shkaktuar deri me datë	12,000	8,000	1,000
Vlerësimi i kostove deri në përfundim	3,000	12,000	4,000
Pagesat e faturuara dhe të pranuar	14,000	6,000	2,000

Kërkohet:

Ne pajtim me SNRF 15 *Të hyrat nga kontratat me klientët* llogaritni shumat që do të njihen për secilën kontratë në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe pasqyrën e pozitës financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024 duke supozuar se shuma e obligimit për performancë llogaritet duke përdorur metoden e kostove proporcionale të shkaktuara. (12 pikë)

2.

a)

Meqenëse obligacioni është blerë me qëllim mbajtjen e tij për një afat të gjatë, testi i modelit të biznesit është përmbushur. Meqenëse rrjedhat e parave të obligacionit përbëhen vetëm nga pagesat e interesit dhe kryegjësë, testi i rrjedhave kontraktuale të parasë është përmbushur. Prandaj, ky obligacion duhet të kontabilizohet duke përdorur metodën e kostos së amortizuar. Obligacioni regjistrohet me koston e tij, plus çdo kosto blerjeje (nuk është e aplikueshme në këtë rast).

	€ milion	€ milion
Debi Pasuria financiare	40.425	
Kredi Paraja		40.425

Më pas, kthimi (norma) efektive deri në maturim duhet të përdoret për të amortizuar obligacionin gjatë vitit. Kjo zbatohet në saldon fillestare për të përcaktuar koston e financimit ($6.75\% \times 40.425 \text{ milionë} = 2.7286 \text{ milionë ose } 2.7 \text{ milionë euro}$).

	€ milion	€ milion
Debi Pasuria financiare	2.7	
Kredi Fitim ose humbje (të hyrat financiare)		2.7

Pagesa e interesit u pagua më 31 dhjetor 2024, sipas kontratës. Kjo është 4% e vlerës nominale prej €47.25 milionë, ose €1.89 milionë. Kjo trajtohet si një zvogëlim i pasurisë financiare.

	€ milion	€ milion
Debi Paraja	1.89	
Kredi Pasuria financiare		1.89

Vlera bartëse me 31 dhjetor 2024 (pa humbje të pritura kreditore të cilat nuk janë të aplikueshme në këte detyrë) = $40.425 + 2.7 - 1.89 = €41.26 \text{ milionë}$

b)

Kontrata 1	<u>PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES</u>	€
Të hyrat $(12,000 / (3,000 + 12,000) \times 20,000)$		16,000
Kosto e shitjes		<u>(12,000)</u>
Fitimi		4,000
Pasuri e kontratës	<u>PASQYRA E POZITËS FINANCIARE</u>	
		2,000
Kostot deri me datë		12,000
Fitimi i atribuar		4,000
Shumat e faturuara		<u>(14,000)</u>
Pasuri/(detyrim) i kontratës		2,000
Kontrata 2	<u>PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES</u>	€
Të hyrat $(8,000 / (8,000 + 12,000) \times 16,000)$		6,400
Kosto e shitjes (shifer balancuese*)		<u>(10,400)</u>
Humbja		(4,000)

*Kosto deri në datë	(8,000)
*Humbja e parashikuar $(4,000 \times 8,000 / (8,000 + 12,000))$	(2,400)

PASQYRA E POZITËS FINANCIARE

Detyrim i kontratës **400**

Pasuri e kontratës	
Kostot deri me datë	8,000
Humbja e parashikuar	(2,400)
Shumat e faturuara	<u>(6,000)</u>
Pasuri/(detyrim) i kontratës	(400)

Kontrata 3 **PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES**

	€
Të hyrat $(1,000 / (1,000 + 4,000) \times 8,000)$	1,600
Kosto e shitjes	<u>(1,000)</u>
Fitimi	600

PASQYRA E POZITËS FINANCIARE

Detyrim i kontratës **400**

Kostot deri me datë	1,000
Fitimi i atribuar	600
Shumat e faturuara	<u>(2,000)</u>
Pasuri/(detyrim) i kontratës	(400)

3. Informacioni i mëposhtëm është nxjerrë nga Pasqyrat Financiare të Graham sh.a.

Pasqyra e pozitës financiare me 31 dhjetor 2024

	2024	2023
	€'000	€'000
Pasuritë		
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>		
Prona, fabrika & paisjet	6,000	5,250
Pasuritë e paprekshme	<u>3,250</u>	<u>1,900</u>
	9,250	7,150
<i>Pasuritë qarkulluese</i>		
Stoqet	3,200	2,450
Të arkëtueshmet tregtare	<u>6,550</u>	<u>6,000</u>
	<u>9,750</u>	<u>8,450</u>
Total pasuritë	19,000	15,600
Ekuiteti & detyrimet		
<i>Ekuiteti</i>		
Akzionet e zakonshme prej €1 secila	4,000	4,000
Fitimet e mbajtura	2,750	1,925
Teprica e rivlerësimit	<u>3,475</u>	<u>2,450</u>
	10,225	8,375
<i>Detyrimet afatgjata</i>		
10% Nota krediti	4,000	3,000
<i>Detyrimet afatshkurta</i>		
Mbitërheqja bankare	550	400
Të pagueshmet tregtare	4,075	3,550
Tatimi aktual i pagueshëm	<u>150</u>	<u>275</u>
	<u>4,775</u>	<u>4,225</u>
Total ekuiteti & detyrimet	19,000	15,600

Informata shtesë:

- i) Ekstrakt nga pasqyra e fitimit ose humbjes për vitin që përfundoi më 31 dhjetor

	2024	2023
	€'000	€'000
Shitjet	56,000	48,750
Kosto e shitjeve	42,300	34,125
Fitimi para tatimit	2,325	1,600

- ii) Fitimi para tatimit u arrit pas ngarkimit të kostove të mëposhtme:

	2024	2023
	€'000	€'000
Zhvlerësimi	1,800	1,400
Interesi në 10% nota krediti	400	300
Shpenzimet tjera administrative	50	50

iii) Koeficientët e mëposhtëm janë mesataret që i përkasin industrisë së Graham sh.a.:

1. Kthimi në kapitalin e angazhuar (KNKA)	17.6%
2. Marzha e fitimit para tatimit	3.95%
3. Marzha e fitimit bruto	33.42%
4. Qarkullimi i pasurisë (kapitalit të angazhuar)	4.30 herë
5. Koeficienti i qarkullimit	1.84:1
6. Koeficienti i shpejtë	1.15:1
7. Periudha e llogarive të arkëtueshme	48 ditë
8. Periudha e llogarive të pagueshme	42 ditë
9. Periudha e qarkullimit të stoqeve	22 ditë
10. Hyrja në borxh	34.21%

Kërkohet:

- a) Llogaritni koeficientët krahasues për Graham sh.a. për vitet 2024 dhe 2023.
(10 pikë)
- b) Shkruani një raport për shqyrtim nga Bordi i Drejtorëve, duke analizuar performancën e Graham sh.a. me referenca për koeficientët për dy vitet dhe mesataret e industrisë.
(10 pikë)
- (Total: 20 pikë)

a) Llogaritja e koeficientëve

Koeficienti	2024	2023	Industria
<u>Kthimi në kapitalin e angazhuar (KNKA)= FPIT / Kapitali i angazhuar x 100</u>			
(2,325+400)/(19,000-4,775) x 100			
(1,600+300)/(15,600-4,225) x100	19.16%		
		16.70%	17.60%
<u>Marzha e fitimit para tatimit = Fitimi neto para tatimit / Shitjet x 100</u>			
2,325/56,000 x100	4.15%		
1,600/48,750 x 100		3.28%	3.95%
<u>Marzha e fitimit bruto = Fitimi bruto / Shitjet x 100</u>			
(56,000-42,300)/56,000 x 100	24.46%		
(48,750-34,125)/48,750 x 100		30.00%	33.42%
<u>Qarkullimi i pasurisë = Shitjet / Kapitali i angazhuar</u>			
56,000/(19,000-4,775)	3.94:1		
48,750/(15,600-4,225)		4.29:1	4.30:1
<u>Koeficienti i qarkullimit = Pasuritë qarkulluese / Detyrimet afatshkurta</u>			
9,750/4,775	2.04:1		
8,450/4,225		2.00:1	1.84:1
<u>Koeficienti i shpejtë = (Pasuritë qarkulluese - Stoqet)/Detyrimet afatshkurta</u>			
(9,750-3,200)/4,775	1.37:1		
(8,450-2,450)/4,225		1.42:1	1.15:1
<u>Periudha e llogarive të arkëtueshme = Të arkëtueshmet tregtare / Shitjet x 365</u>			
6,550/56,000 x 365	43 ditë		
6,000/48,750 x 365		45 ditë	48 ditë
<u>Periudha e llogarive të pagueshme = Të pagueshmet tregtare / Kosto e shitjeve x 365</u>			
4,075/42,300 x 365	35 ditë		
3,550/34,125 x 365		38 ditë	42 ditë
<u>Periudha e qarkullimit të stoqeve = Kosto e shitjeve / Stoqet</u>			
3,200/42,300 x 365	28 ditë		
2,450/34,125 x 365		26 ditë	22 ditë
<u>Hyrja në borxh = (Borxhi me interes / (Ekuiteti i aksionarëve + Borxhi me interes)) x 100</u>			
4,000/(19,000-4,775) x 100	28.12%		
3,000/(15,600-4,225) x 100		26.37%	34.21%

b)

Raport për Bordin e Drejtorëve

Për: Bordin e drejtorëve

Nga: Kontabilisti financiar

Tema: Analiza e performances së Graham sh.a.

Hyrje

Ky raport ofron një analizë të performancës së Graham sh.a. për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2024 në krahasim me vitin 2023 dhe mesataret e industrisë. Raporti duhet të lexohet së bashku me shtojcën bashkëngjitur e cila tregon koeficientët përkatës për periudhat përkatëse dhe mesataret e industrisë.

Rentabiliteti

Kthimi në kapitalin e angazhuar është përmirësuar dukshëm midis viteve dhe tani është gjithashtu pak më lart se mesatarja e industrisë.

Fitimi para tatimit si përqindje shitjeve është përmirësuar gjithashtu dukshëm midis viteve dhe tani është gjithashtu pak më lart se mesatarja e industrisë. Megjithatë, marzhi i fitimit bruto është dukshëm më i ulët se në vitin e kaluar dhe është vetëm rreth 73% e mesatares së industrisë. Kjo sugjeron që ose ka pasur një ndryshim në strukturën e kostos së Graham sh.a. ose që ka pasur një ndryshim në metodën e ndarjes së kostos midis periudhave. Sidoqoftë, ky është një ndryshim i dukshëm që kërkon hetim.

Kompania mund të jetë në një periudhë tranzicioni pasi shitjet janë rritur me gati 15% gjatë vitit dhe mund të duket se janë blerë pasuri të reja jo-qarkulluese.

Qarkullimi i pasurive (kapitalit të angazhuar) ka rënë midis këtyre periudhave, megjithëse shifra e vitit 2023 është afër mesatares së industrisë. Ky zvogëlim mund të tregojë se efikasiteti me të cilin përdoren pasuritë është përkeqësuar ose mund të tregojë se pasuritë e blera në vitin 2024 nuk kanë kontribuar ende plotësisht në biznes. Një trend afatgjatë do ta sqaronte situatën.

Likuiditeti dhe menaxhimi i kapitalit qarkullues

Koeficienti i qarkullimit është përmirësuar pak gjatë vitit dhe është pak më i lartë se mesatarja e industrisë. Është gjithashtu në përputhje me atë që përgjithësisht konsiderohet e kënaqshme. (2:1).

Megjithatë, koeficienti i shpejtë ka rënë pak, por është ende më i mirë se mesatarja e industrisë. Kjo sugjeron që Graham sh.a. nuk ka probleme me likuiditetin afatshkurtër dhe nuk duhet të ketë vështirësi në pagesën e borxheve të saj kur ato bëhen të skadueshme.

Periudha e arkëtimit të arkëtueshmeve nuk ka ndryshuar ndjeshëm nga viti 2023 dhe është dukshëm më e ulët se mesatarja e industrisë. Si pasojë, ndoshta ka pak mundësi për ta ulur më tej këtë dhe mund të ketë presion në të ardhmen nga klientët për të rritur periudhën e blerjeve me afat pagese. Periudha e pageses së furnitorëve ka rënë nga 38 ditë në 35 ditë dhe është shumë më e ulët se mesatarja e industrisë. Kështu, mund të jetë e mundur të financohen çdo llogari shtesë e arkëtueshme duke negociuar kushtet e kredisë nga furnitorët.

Qarkullimi i stokeve ka rënë pak dhe është shumë më i ngadaltë se mesatarja e industrisë dhe kjo mund të pasqyrojë pjesërisht grumbullimin e stokeve përpara një rritjeje të ndjeshme të shitjeve. Nga ana tjetër, ekziston një rrezik që stoqet të përmbajë disa artikuj të vjetëruar që

mund të kërkojnë shlyerje. Rritja relative në nivelin e stoqeve është financuar nga një rritje e mbiterheqjes e cila mund të ulet nëse niveli i stoqeve ulet.

Niveli i lartë i stoqeve, mbiterheqjes dhe të arkëtueshmeve krahasuar me atë të të pagueshmeve sugjeron një kompani me kapital qarkullues intensiv ose një kompani ku produkteve të blera u shtohet vlerë e konsiderueshme.

Leverazhi

Niveli i borxhit është rritur vetëm pak nga viti 2023 në vitin 2024 dhe është ende nën nivelin standard të industrisë. Ende ka hapësirë modeste për rritje të nivelit të borxhit për të financuar pasuritë, duke rritur kështu rentabilitetin, pasi kthimi mbi kapitalin e angazhuar është pothuajse dyfishi i normës së interesit për notat e kredisë.

Konkluzion

Në përgjithësi, Graham sh.a. është përmirësuar ndjeshëm nga viti i kaluar në vitin aktual, por do të kërkojë ende një rishikim të politikës së saj të kapitalit qarkullues dhe kontributit të pasurive në shitje për të arritur përfitimet e plota të investimeve që po bëhen si në pasuritë qarkulluese e poashtu edhe në ato jo-qarkulluese.

4. Informacioni i mëposhtëm lidhet me draft-pasqyrat financiare të Soros sh.a. për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2024 dhe të dhënat krahasuese të vitit 2023 në pasqyrën e pozitës financiare.

Pasqyra e fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar me

	31 dhjetor 2024
	€
Shitjet	495,000
Kosto e shitjeve	<u>(394,200)</u>
Fitimi bruto	100,800
Shpenzimet administrative	(72,000)
Kosto e shpërndarjes	<u>(36,000)</u>
Fitimi/ (humbja) operative	(7,200)
Kosto financiare	<u>(7,200)</u>
Fitimi/(humbja) para tatimit	(14,400)
E adhurs/(shpenzim) i t atimi në fitim	<u>4,500</u>
Fitimi/(humbja) për vitin	<u>(9,900)</u>

Pasqyra e pozitës financiare me 31 dhjetor:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
	€	€
Pasuritë		
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>		
Prona, fabrika dhe paisjet	171,000	229,500
<i>Pasuritë qarkulluese</i>		
Stoqet	112,500	41,400
Të arkëtueshmet tregtare	40,500	18,000
Tatimi i arkëtueshëm (rimbursim)	4,500	-
Paraja	<u>-</u>	<u>13,500</u>
	157,500	72,900
Total pasuritë	328,500	302,400
Ekuiteti dhe detyrimet		
<i>Ekuiteti</i>		
Aksionet e zakonshme prej €1 secila	90,000	72,000
Premia e aksioneve	28,800	36,000
Fitimet e mbajtura	<u>40,500</u>	<u>56,700</u>
	159,300	164,700
<i>Detyrimet afatgjata</i>		
12% notë kreditore	15,000	20,000
Granti qeveritar	30,000	25,000
Detyrimet ndaj lizingut	20,000	18,000
Tatimi i shtyrë	<u>34,000</u>	<u>7,200</u>
	99,000	70,200

<i>Detyrimet afatshkurtra</i>		
Të pagueshmet tregtare	32,300	30,000
Mbitërheqja bankare	12,600	-
Tatimi aktual i pagueshëm	-	22,500
Granti qeveritar	10,000	7,800
Detyrimet ndaj lizingut	<u>15,300</u>	<u>7,200</u>
	70,200	67,500
Total ekuiteti dhe detyrimet	328,500	302,400

Informacionet shtesë relevante për pasqyrat financiare të mësipërme përfshijnë:

- i) Prona, pabrika dhe paisjet përbëhen si në vijim:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
	€	€
Prona, pabrika dhe paisjet	132,500	207,000
Pasuri me të drejtë të përdorimit (PMDP)	<u>38,500</u>	<u>22,500</u>
	171,000	229,500

Gjatë vitit deri më 31 dhjetor 2024, fabrika në pronësi me vlerë kontabël prej €54,000 u shit për €76,500. Zhvlerësimi i përfshirë në koston e shitjeve për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024 është €33,300. Pasuria me të drejtë të përdorimit e blerë gjatë vitit deri më 31 dhjetor 2024 ishte €20,400. Nuk pati shitje të PMDP-së gjatë vitit deri më 31 dhjetor 2024.

- ii) Gjatë vitit, në shpenzimet administrative u kreditua një shumë prej €9,500 në lidhje me grantet qeveritare.
- iii) Më 1 maj 2024, pati një emetim bonus të aksioneve nga premia e aksioneve prej 2 aksionesh të reja për çdo 5 aksione të mbajtura. Në të njëjtin vit, më 1 gusht, pati një emetim të të drejtave të aksioneve të ushtruara plotësisht.

Kërkohet:

Përgatitni një pasqyrë të rrjedhave të parasë për Soros sh.a. për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2024 në pajtim me SNK 7 Pasqyra e rrjedhave të parasë, duke përdorur metodën indirekte.

(20 pikë)

i)

Soros sh.a

Pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024.

€

Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative

Humbja para tatimit	(14,400)
Shto: Shpenzimet e zhvlerësimit	33,300
Minus: Amortizimi i grantit qeveritar	(9,500)
Minus: fitimi nga shitja e PFP (L11)	(22,500)
Shto: kostot financiare në fitim ose humbje	<u>7,200</u>
Paraja e gjeneruar nga operacionet para korigjimeve të kapitalit qarkullues	(5,900)
Rritja në stoqe	(71,100)
Rritja në të arkëtueshmet	(22,500)
Rritja në të pagueshmet	<u>2,300</u>
Daljet e parasë nga operacionet	(97,200)
Interesi i paguar	(7,200)
Rimbursimi i tatimit (L15)	<u>4,300</u>
Neto rrjedhat e parasë nga aktivitetet operative	(100,100)

Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese

Paraja e paguar për bklerjen e PFP (L12)	(8,400)
Arkëtimet nga shitja e PFP	76,500
Pranimi i grantit qeveritar (L13)	<u>16,700</u>
Neto rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese	84,800

Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese

Arkëtimet nga emetimi i aksioneve (90,000 + 28,800 - 72,000 - 36,000)	10,800
Pageasat e lizingut (L14)	(10,300)
12% Nota kreditore e paguar (20,000-15,000)	(5,000)
Dividenda e paguar (L16)	<u>(6,300)</u>
Neto rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese	(10,800)
Neto zvogëlimi në paranë dhe ekuivalentët e parasë	(26,100)
Paraja dhe ekuivalentët e parasë me 1 janar 2024	<u>13,500</u>
Paraja dhe ekuivalentët e parasë me 31 dhjetor 2024	(12,600)

Llogaritjet**1. Fitimi ose humbja nga shitja e PFP**

€

Shitja	76,500
Shuma bartëse	<u>(54,000)</u>
Fitimi nga shitja	22,500

2. Blerja e PFP

Kosto ose vlerësimi s/ fillim	229,500
PMDP e re	20,400
Shitja	(54,000)
Shpenzimet e zhvlerësimit	(33,300)
Blerja (saldo balancuese)	<u>8,400</u>
Kosto ose vlerësimi s/fund	171,000

3. Granti qeveritar i pranuar	€
Granti qeveritar s/ fillim – afatshkurtë	7,800
Granti qeveritar s/ fillim – afatgjatë	25,000
Amortizimi në fitim ose humbje	(9,500)
Granti qeveritar i pranuar (saldo balancuese)	<u>16,700</u>
Granti qeveritar s/fund (afatshkurtë + afatgjatë)	40,000
 4. Pagesat e lizingu	 €
Detyrimet afatshkurta s/ fillim	7,200
Detyrimet afatgjata s/ fillim	18,000
Pasuaria e re e marre me lizing	20,400
Pagesat e lizingu (saldo balancuese)	<u>(10,300)</u>
Detyrimet e lizingut s/fund (afatshkurtë + afatgjatë)	35,300
 5. Tatimi i paguar	 €
E ardhur nga tatimi ne fitim ose humbje	4,500
Minus tatimi aktual s/ fillim	(22,500)
Minus tatimi i shtyrë s/ fillim	(7,200)
Plus tatimi i shtyrë s/ fund	34,000
Minus tatimi aktual s/ fund	<u>(4,500)</u>
Rimbursim i tatimit (saldo balancuese)	4,300
 6. Dividenda e paguar	
Fitimet e mbajtura në fillim	56,700
Minus humbja e vitit	(9,900)
Minus saldo në fund	<u>(40,500)</u>
Dividenda e paguar	6,300

5.

(a) Bogle sh.a shet pajisje telekomunikacioni për kompanitë në industrinë e telekomunikacionit. Më 1 janar 2024, Bogle sh.a nënshkroi një kontratë me Buss sh.a për të furnizuar pajisjet dhe për të ofruar shërbime pas shitjes për pesë vite (duke filluar nga data e dorëzimit të pajisjes). Çmimi i kontratës është €500,000. Pajisjet e telekomunikacionit ka një çmim prej €360,000 nëse blihet ndarazi dhe shërbimet pas shitjes mund të ofrohen ndarazi për €240,000. Pajisjet u dorëzuan më 30 qershor 2024 dhe obligimi i performancës për shërbimin pas shitjes për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2024 u përmbush.

Kërkohet:

Shpjegoni se si Bogle sh.a duhet ta kontabilizoj këtë kontratë, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024, duke përdorur modelin me pesë hapa të SNRF 15 *Të hyrat nga kontratat me klientët*. (8 pikë)

(b) Dalio sh.a bleu një biznes (njësi gjeneruese parash) më 1 janar 2024 për €950,000. Vlerat kontabël të njësisë gjeneruese të parave më 31 dhjetor 2024 ishin:

	€
Prona	250,000
Fabrika dhe pajisjet	150,000
Zëri i mirë	75,000
Patenta	180,000
Të arkëtueshmet tregtare (shuma e rikrthyeshme)	120,000
Paraja	125,000
Të pagueshmet tregtare	<u>(100,000)</u>
	800,000

Më 31 dhjetor 2024, njësia gjeneruese e parave të gatshme u rishikua për dëmtim dhe kishte vlerën në përdorim prej €550,000 dhe vlerë të drejtë të pasurisë minus shpenzimet për të shitur prej €600,000. Vlera neto e realizueshme e patentës kishte rënë në €155,000.

Kërkohet:

i) **Shpjegoni ndryshimin midis 'vlerës në përdorim' dhe "vlerës së drejtë të pasurisë minus shpenzimet për ta shitur" të një pasurie. (2 pikë)**

ii) **Ilogaritni humbjen nga dëmtimi i njësisë gjeneruese të parash me 31 dhjetor 2024. (2 pikë)**

iii) **shpjegoni se si duhet të alokohet humbja nga dëmtimi i njësisë gjeneruese të parash dhe vlera e saj në pasqyrën e pozitës financiare me 31 dhjetor 2024 sipas SNK 36 *Dëmtimi i pasurive*. (3 pikë)**

(c) Shumica e kompanive multinationale i përgatisin pasqyrat e tyre financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), pasi ato mendojnë se lëvizja drejt harmonizimit global të SNRF-ve ka më shumë përfitime sesa kosto.

Kërkohet:

Shpjegoni pesë (5) përfitime të harmonizimit global të SNRF-ve për kompanitë multinationale. (5 pikë)

5. (a) Modeli me pesë hapa

1. Identifiko kontratën me klientin.

Bogle sh.a ka një kontratë me Buss sh.a për të furnizuar pajisjet e telekomunikacionit dhe për të ofruar shërbime pas shitjes për 5 vjet..

2. Identifiko obligimet për performancë..

Bogle sh.a ka 2 obligimet për performancë.

(i) Për të furnizuar pajisje telekomunikacioni.

(ii) Të ofrojë shërbime pas shitjes për 5 vjet.

3. Përcakto çmimin e transaksionit.

Bogle sh.a ka përcaktuar çmimin e transaksionit prej €500,000.

4. Aloko çmimin e transaksionit tek obligimet për performancë.

	€	%
Paisja	€360,000	60
Kontrata – dy vjet	<u>€240,000</u>	<u>40</u>
Total vlera	€600,000	100

Bogle sh.a duhet të ndajë €300,000 ($€500,000 \times 60\%$) si të ardhura nga pajisjet e telekomunikacionit dhe €200,000 ($€500,000 \times 40\%$) si të ardhura nga shërbimet pas shitjes.

5. Njihi të hyrat kur të (apo sipas) përmbushen obligimet për performancës.

Të ardhurat (€300,000) për pajisjet e telekomunikacionit duhet të njihen më 30 qershor 2024, kur pajisjet dorëzohen. Të ardhurat (€200,000) për shërbimet pas shitjes duhet të njihen gjatë 5 viteve. Vetëm €20,000 ($(€200,000/60 \times 6)$) duhet të njihen për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024.

(b)

- i) Vlera në përdorim e një pasurie matet si vlera e tanishme e rrjedhave të ardhshme të parasë (hyrjet minus daljet) të gjeneruara nga pasuria, duke përfshirë vlerën neto të vlerësuar (nëse ka) në fund të jetës së pritur të përdorimit.

Vlera e drejtë e pasurisë minus shpenzimet për të shitur është shuma neto e shpenzimeve të shitjes që mund të përfitohen nga shitja e pasurisë. Shpenzimet e shitjes përfshijnë shpenzimet e transaksionit të shitjes, siç janë shpenzimet ligjore.

- ii) Nëse shuma e rikthyeshme e një pasurie është më e ulët se sa vlera bartëse, shuma bartëse duhet të reduktohet për diferencën (dmth. humbja nga dëmtimi) e cila duhet të ngarkohet si shpenzim në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

Shuma e rikthyeshme e një pasurie duhet të matet si vlera më e lartë e:

- a) vlerës së drejtë të pasurisë minus shpenzimet për të shitur (€600,000); dhe
- b) vlera e saj në përdorim (€550,000)

$$\text{Humbja nga dëmtimi} = 600,000 - 800,000 = (200,000)$$

- iii) Kur një humbje nga dëmtimi njihet për njësinë gjeneruese të parasë, humbja duhet të alokohet në mes të pasurive në njësi sipas radhës në vijim.
- Së pari, tek çfarëdo pasurie që është qartas e dëmtuar apo shkatërruar (në këtë rast patenta)
 - Pastaj tek zëri i mirë i alokuar nësisë gjeneruese të parasë
 - Pastaj tek të gjitha pasuritë tjera në njësinë gjeneruese të parasë, në baza proporcionale (duke perjashtuar ne kete rast paranë dhe llogarite e arketueshme te cilat jane te treguara ne shumat e tyre te rikthyeshme)

Alokimi i humbjes nga dëmtimi

	Shuma bartëse	Dëmtimi	Shuma e rikthyeshme
	€	€	€
Prona	250,000	(62,500)*	187,500
Fabrika dhe paisjet	150,000	(37,500)*	112,500
Zëri i mirë	75,000	(75,000)	-
Patenta	180,000	(25,000)	155,000
Të arkëtueshmet tregtare	120,000	-	120,000
Paraja	125,000	-	125,000
Të pagueshmet tregtare	<u>(100,000)</u>		<u>(100,000)</u>
	800,000	(200,000)	600,000

* Ndarë në bazë proporcionale.

Prona = $250,000 / (250,000 + 150,000) \times 100,000$ (humbja e paalokuar) = 62,500

Fabrika dhe paisjet = $150,000 / (250,000 + 150,000) \times 100,000$ (humbja e paalokuar) = 37,500

Vlera për t'u raportuar në pasqyrën e pozitës financiare €600,000.

(c) Kompanitë multinacionale do të përfitonin prej harmonizimit për shumë arsye duke përfshirë arsyet në vijim:

- Qasje më e mirë do të fitohej për fondet e investitorëve të huaj.
- Kontrolli i menaxhmentit do të përmirësohej sepse harmonizimi do t'i ndihmonte komunikimit të brendshëm të informatave financiare.
- Vlerësimi i entiteteve të huaja për ata që marrin nën kontroll dhe ata që bashkohen do të ishte më i lehtë.
- Do të ishte më lehtë të arrihej përputhja me kërkesat e raportimit të bursave jashtë vendit.
- Përgatitja e llogarive grupore do të ishte më e lehtë.
- Do të mund të arrihej reduktimi në kostot e auditimit .
- Bartja e stafit të kontabilitetit përtej kufijve kombëtarë do të ishte më e lehtë.